



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA - PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. prot. Prot. No.
20/DPK	01-1242/15
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	29.04.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-505/15, për z. Halim Halimi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02- 505/15, për zyrtarin e lartë, z. Halim Halimi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

z. Halimi është hetuar për konflikt interesi sepse ka marrë pjesë në procedurat e vendimmarrjes në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës të datës 14 Janar 2015 dhe seancën e rregullt të datës 05 Shkurt 2015, në të cilat është diskutuar lidhur me shkarkimin dhe emërimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike të Komunës së Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), i ka dërguar z. Halimi shkresën zyrtare përmes së cilës e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës kemi organizuar takim në zyrat e AKK-së në të cilin është njoftuar me pretendimet e palës denoncuese në lidhje me situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Nga Ekstrakti i Procesverbalit të Mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe në takim me z. Halimi, kemi vërtetuar se së pari janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve ndërsa, më pas është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale të Prishtinës.

Nuk qëndron pretendimi i denoncuesit të rastit se votimi i z. Halimi, për çështjet që ndërlidhen me ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës përbën konflikt interesi sepse vajza e tij është punësuar në “Ndërmarrjen Publike Banesore” kur z. Halimi ka qenë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve. Kjo për arsye se ky fakt nuk ia mohon të drejtën e z. Halimi për të votuar për zgjedhjen e Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

